

ÇËSHTJET E REFORMËS NË SISTEMIN GJYQËSOR TË KOSOVËS

Mr.sc Rafet Haxhaj*

Abstrakt:

Reformimin e gjyqësorit si proces të domosdoshëm e determinuan ndryshimet shoqërore, ekonomike e politike që u bënë në Kosovë. Këto ndryshime shënuan jo vetëm fundin e një regjimi komunist, por edhe ndarjen nga juridiksioni i ish Jugosllavisë dhe Serbisë dhe hyrjen e Kosovës në tranzicion të vështirë drejt sistemit demokratik, pluralist dhe ekonomisë së tregut të lirë. Sistemi Gjyqësor që u ndërtua menjëherë pas luftës përmbante në vete edhe një pjesë të sistemit të kaluar si nga organizimi i gjykatave, procesit të punës në to e po ashtu edhe normat ligjore të së kaluarës dhe me të gjitha këto edhe mentalitetin e vjetër juridik. Çështja e pazgjidhur e statusit final të Kosovës bëri që për një kohë të këtë zvarritje në fillimin e reformës së gjyqësorit. Ndarja e kompetencave lidhur me administrimin e gjyqësorit në mes të Departamentit të Drejtësisë (Shtylla e Parë e UNMIK-ut), Departamentit të Administratës Gjyqësore që për një kohë ishte në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike e më vonë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me Përfaqësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) si autoritet i fundit, nuk dhanë rezultatet e pritura se me në fund reforma në gjyqësor do të fillojë dhe se çështjet do të merrnin kahun e zgjidhjes së tyre. Figura e gjykatësit e cila kudo në botë është figurë e respektuar, në Kosovën nën administrimin e Misionit të Kombeve të Bashkuara u degrada në atë masë, sa që, ishte shumë herë më e dobët se një përkthyes i thjeshtë UNMIK-u apo OSBE-je, ose e një punëtori të administratës në ndërmarrjet publike. Në nivelin organizativ kaluan plot tetë vite pas instalimit të Misionit të mbikqyrjes ndërkombëtare në Kosovë dhe edhe më tutje nuk është bërë nxjerrja e Ligjit për Gjykatat dhe e një rregulloreje për organizimin e veprimtarisë së brendshme të tyre. Gjykatat “vuajnë” edhe më tutje nga shumë punë që bien në fushëveprimtarinë e funksionit të noterisë, sektorit të punëve të brendshme, të administratës lokale etj. Gjyqësorit në

* Mr.sc Rafet Haxhaj, Gjykatës në Gjykatën Komunale në Klinë- Kosovë, dhe kryeredaktor i Buletinit të Shoqatës së Gjykatësve të Kosovës. Opinionet e shprehura në këtë artikull janë vetëm të autorit dhe nuk shprehin qëndrimin e organizatës për të cilën ai punon.

Kosovë i nevojitet një reformë edhe në aspektin ligjor. Nxjerrja e Kodeve të reja penale (Kodit Penal dhe atij të procedurës), Ligjit për Familjen, Ligjit për Trashëgimin etj sikur kanë freskuar strukturën ligjore në Kosovë, megjithatë mbetet edhe shumë punë për t'u bërë në këtë drejtim. Nevoja e angazhimit të të rinjve në gjyqësorin e Kosovës, organizimi i mësimit klinik për studentët e drejtësisë dhe përmirësimi në shkallë vendi në aspektin e shkrimit ligjor si dhe hapja e një shkollë të magistraturës mbetën disa nga sfidat e gjyqësorit të Kosovës në të ardhmen.

Fjalët kyç: *Reformë, Sistem Gjyqësor, kompetencë, mision, mësim klinik, Shkollë e Magistraturës.*

1. Një historik shkurtër i ndërtimit të sistemit gjyqësor në Kosovë

Institucionet e gjyqësisë në Kosovë u lindën dhe u ndërtuan në rrethana tejet specifike, nëpër periudhat e ndryshme kohore. E kaluara historike e Kosovës dëshmon se ajo qysh herët identifikohet si njësi territoriale, administrative e politike e emërtuar me emrin Vilajeti i Kosovës (1868).² Përprjekjet e shqiptarëve për autonomi, si hap i parë drejt pavarësisë nga sundimi turk, paraqiten tek aktiviteti politik i Lidhjes së Prizrenit (1878-1881). Në këtë kohë paraqiten edhe gjykatat e para në trevat shqiptare së bashku me shërbimet e tjera të cilat i kryenin nëpunësit për popullatën në atë kohë. Në kryeqendrën e Vilajetit të Kosovës në Prishtinë, në mars të vitit 1879, shfaqet lëvizja kundër gjyqeve të ndërlikuara dhe të korruptuara osmane. Kjo lëvizje e kryesuar nga Zija Prishtina, në majin e vitit 1789, i paraqiti Portës së Lartë, në emër të sanxhikut të Prishtinës, një peticion me të cilin ndër të tjera kërkohej formimi i gjyqeve të pavarura dhe largimi i ushtrisë osmane.³ Porta e Lartë në këtë kohë lejoi që krahas gjyqeve zyrtare të funksionojnë edhe gjykatat shqiptare.⁴ Në vitin 1880 në Prizren, por edhe gjetiu, në trevat shqiptare vendoset një administrim nëpunësish, të cilët kryenin shërbime për popullatën e

² Shukri Rahimi, *Vilajeti i Kosovës*, Prishtinë 1969, fq. 12.

³ Ramiz Abdyli, Emine Bakalli, *Historia II- Gjinnazi i shkencave shoqërore*, Libri Shkollor, Prishtinë 2004, fq. 159.

⁴ Po aty;

cila kishte nevojë për to. Atëbotë formohen dhe funksionojnë disa institucione dhe mekanizma, kryesisht gjykata.⁵

Në fundvitin e vitit 1880 dhe fillimin e vitit 1881 sukseset e Lidhjes së Prizrenit ishin aq të mëdha, sa që nisi të flitet edhe për shtetin e pavarur dhe formën e regjimit të këtij shteti. Kudo që shtrihej autoriteti i Lidhjes së Prizrenit, u punua për ngritjen e administratës së re, në vendosjen e rregullit dhe rendit, në themelimin e gjyqeve shqiptare, në ngritjen e forcave të armatosura, në krijimin e fondeve financiare etj.⁶

Pas aneksimit nga Serbia dhe ngjarjeve të pas Luftës së Parë Botërore, Kosova zhvishet nga çfarëdo lloj autonomie duke u copëtuar në njësi të ndryshme administrative. Që nga koha e organizimit politiko-ushtarak të Lidhjes së Prizrenit (1878) e gjerë me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore nuk mund të flitet për organizim të sistemit gjyqësor në nivel të institucioneve vendore.

Populli shqiptar, ndonëse nën sundimin e të huajve, sidomos në krahinat malore, ku pushteti i të huajve nuk ka mundur të jetë permanent, marrëdhëniet shoqërore, pronësore, penale etj., i ka rregulluar me të drejtën zakonore dhe kontestet gjyqësore i ka zgjidhur nëpërmjet pleqësive. Pra në mungesë të pushtetit qendror, pleqësia ishte ai organ gjyqësor i cili merrej me gjykimin e çështjeve të ndryshme penale, civile etj.⁷

Pas Luftës së Dytë Botërore Sistemi Gjyqësor në Kosovë u ngrit dhe u zhvillua i determinuar nga shkalla e autonomisë, që në ato etapa kohore gëzonte Kosova. Gjatë kësaj periudhe Sistemi Gjyqësor i Kosovës arrin që të barazohet me sistemet gjyqësore të njësive të tjera të ish Federatës Jugosllave. Me rrënimin e autonomisë së Kosovës nga regjimi i egër i diktatorit Milosheviç, krahas rrënimit të institucioneve të tjera, të njëjtin fat e përjeton edhe Sistemi Gjyqësor i Kosovës.

⁵ Dr. Arsim Bajrami, *E Drejta kushtetuese II*, Prishtinë, 1998, fq. 14.

⁶ Ramiz Abdyli, Emine Bakalli, *Historia II- Gjimnazi i shkencave shoqërore*, Libri Shkollor, Prishtinë 2004, fq. 161.

⁷ Ejup Sahiti, *"Sistemi Gjyqësor në Kosovë"*, kumtesë e mbajtur në Konferencën Rajonale për Punën e Sistemit Gjyqësor, Prishtinë, 25-27 prill 2003, botoi KLMDNJ, Prishtinë, 2003.

Sistemi Gjyqësor veprimtarinë e tij do ta rifillojë vetëm pas përfundimit të luftës në Kosovë në vitin 1999, kur edhe Këshilli i Sigurimit të OKB-së miraton Rezolutën 1244 dhe kur Kosova praktikisht vihet nën administrimin ndërkombëtar.

2. Reformimi i gjyqësorit, proces i domosdoshëm

Teoria e së drejtës reformën e përkufizon si ndryshim evolutiv që ndodh në shtet dhe në të drejtë.⁸ Reformimin e gjyqësorit si proces të domosdoshëm e determinuan ndryshimet shoqërore ekonomike e politike që u bënë në Kosovë. Këto ndryshime shënuan jo vetëm fundin e një regjimi komunist, por edhe ndarjen nga juridiksioni i ish Jugosllavisë dhe Serbisë dhe hyrjen e Kosovës në tranzicion të vështirë drejt sistemit demokratik, pluralist të ekonomisë së tregut të lirë etj. Në rrethana të këtylla në Kosovë u hap rruga dhe u ndie nevoja për një reformë të thellë në sistemin ligjor dhe në atë gjyqësor. Sistemi gjyqësor që u ndërtua menjëherë pas luftës përmbante në vete edhe një pjesë të sistemit të kaluar si nga organizimi i gjykatave, procesit të punës në to, po ashtu edhe normat ligjore të së kaluarës dhe me këtë edhe të mendimit juridik të kaluar.

Procesi i reformimit të gjyqësorit ishte e domosdoshme që të fillojë shumë kohë më parë. Mirëpo, kjo gjë nuk ndodhi dhe këtë e determinuan faktorë të shumtë. Në radhë të parë çështja e pazgjidhur e statusit final të Kosovës bëri që të ketë zvarritje në këtë drejtim. Po ashtu ndarja e kompetencave lidhur me administrimin e gjyqësorit e ndarë në mes të disa departamenteve e më vonë në mes të Departamentit të Drejtësisë (Shtylla e Parë e UNMIK-ut) dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe me PSSP-në, si autoritetin e fundit, nuk dhanë rezultatet e pritura se më në fund reforma në gjyqësor do të kryhej në një afat të shpejtuar, dhe se çështjet do të merrnin kahun e duhur të zgjidhjes së tyre. Edhe ndarja e buxhetit që u la në vullnetin e ekzekutivit (qeverisë) për pjesën e vendorëve dhe buxhet i veçantë për stafin ndërkombëtar, thelloi shumë hendekun ndërmjet gjykatësve vendorë dhe atyre ndërkombëtarë (në pozitën e tyre).

⁸ Dr.sc Osman Ismaili, *Fillet e së drejtës*, Prishtinë 2007, fq. 47-48.

Figura e Gjykatësit e cila kudo në vendet e tjera është figurë e respektuar, në Kosovë u degrada dhe pozita e gjykatësit vendor ishte shumë here më e dobët se një përkthyes i thjeshtë në UNMIK, apo OSBE dhe e një punëtori të administratës me nivel të shkollimit të mesëm në ndërmarrjet publike. U deshën që të kalojnë rreth tetë vite dhe të mos nxirret ende një ligj për organizimin e gjykatave dhe të mos ketë edhe një rregullore për veprimtarinë e brendshme të tyre. Gjyqtarët një pozitë të këtillë e panë si mungesë të respektit nga ana e institucioneve për gjyqësinë.⁹

Struktura e gjyqësorit çfarë ishte në Kosovën nën administrimin ndërkombëtar u pa qartë se nuk mund t'i rezistojë ndryshimeve të kohës edhe pse me të madhe u proklamua se do të fillojë reforma në aspektin organizativ, kjo nuk ndodhi. Ligji për Gjykatat dhe Ligji për Noterinë vonuan që të marrin formën përfundimtare të draftimit të tyre dhe ndonëse u shqyrtuan shumë versione të Ligjit për Gjykatat, një draftligj i tillë vonoi në procedurën e nxjerrjes së tij.

Bartja e një numri të kompetencave nga ndërkombëtarët tek Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në prill të vitit 2006 u pa si një fillim i reformës në gjyqësorin e Kosovës. Ndonëse nuk bëri atë që e prisnin gjyqtarët vendor nga ai, megjithatë Këshilli Gjyqësor u bë adresa e parë ku gjyqtarët vendorë, por edhe stafi ndihmës do t'i adresonin problemet e tyre. Ky Këshill mori përsipër menaxhimin e gjyqësorit, ishte përgjegjës për organizimin dhe funksionimin e gjykatave, për ofrimin e kushteve teknike për funksionimin e gjykatave, jepte propozimin për emërimet dhe bënte disiplinimin e gjyqtarëve, mirëpo nuk e kishte edhe të drejtën që të marrë pjesë në ndarjen e buxhetit për gjyqësorin.

Hap tjetër drejt reformimit të gjyqësorit është edhe përmirësimi i infrastrukturës ligjore koherente me nevojat e zhvillimit të procedurave gjyqësore. Nxjerrja e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, nxjerrja e Ligjit për Familjen, Ligjit për Trashëgiminë etj., janë disa nga ligjet të cilat kanë bërë përmirësimin e infrastrukturës ligjore. Edhe pse nxjerrja e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe Kodit të Përkohshëm të Procedurës

⁹ Shih ABA Rule of Law Initiative, *Indeksi i Reformës Gjyqësore në Kosovë*, Vëllimi III, Gusht 2007.

Penale të Kosovës ka ndikuar në përmirësimin në fushën penale në përgjithësi, megjithatë në këtë drejtim ka mbetur edhe shumë që të punohet.

Kështu, sa i përket gjyqësorit, në perspektivën e afërt, ai domosdo duhet që të kryej reformën e tij të thellë si në sferën organizative, po ashtu, edhe në të gjitha sferat e tjera që lidhen me të. Kjo nënkupton nxjerrjen e Ligjit për Gjykatat, i cili do të përcaktonte numrin e gjykatave, strukturën e tyre, shtrirjen gjeografike, kompetencën gjyqësore etj. Ligji gjithashtu do të bënte në mënyrën më të mirë caktimin e mënyrës së funksionimit të Këshillit Gjyqësor, mënyrat e zgjedhjes së gjykatësve, avancimin e tyre, arsimimin ligjor, disiplinimin dhe shkarkimin, rregullimin e kompetencave ndërmjet kryetarit dhe administratorit të gjykatave, të drejtat dhe detyrat e gjyqtarëve, mbrojtjen ligjore të tyre, për mendimet e shprehura gjatë marrjes së vendimeve etj. Ky ligj do të shfuqizonte rregulloret e shumta të cilat ishin në fuqi në kohën nën administrimin OKB-së dhe zbatuesit e ligjit do të kishin në duar një ligj praktik lehtë për t'u kuptuar dhe zbatuar.

Reformës së Sistemit Gjyqësor do t'i kontribuonte në masë të duhur edhe vazhdimi i nxjerrjes së ligjeve të reja dhe ndryshimit të atyre dispozitave ligjore ekzistuese në mënyrë që t'i përshtateshin realitetit të ri ligjor. Kështu, pas nxjerrjes së Ligjit për Procedurën Kundërshtuese dhe Ligjit për Procedurën Jo-kundërshtuese, ndihet nevoja e hartimit të praktikumeve për aplikim praktik të tyre. Nevoja e hartimit të praktikumeve ndihet edhe lidhur me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale dhe praktikumeve të ligjeve të tjera.

Sistemi gjyqësor në të ardhmen domosdo duhet që të lirohet nga punët jogjyqësore dhe ato që nuk bien në fushëveprimtarinë e tij. Më nxjerrjen e Ligjit për Noterinë, këto punë do të shkarkoheshin nga gjyqësori dhe me to do të merrej organi i formuar me ligj, dhe në këtë mënyrë gjyqësori do t'i përkushtohet punës së tij, zgjidhja e lëndëve gjyqësore dhe jo edhe ngarkesat administrative.

Ndihet nevoja e mësimi klinik të kadrove gjyqësore ku mësimi në aspektin teorik do të plotësohet me atë praktik, gjë që do të ishte ndihmesë e madhe drejt reformimit të Sistemit Gjyqësor. Në shumë vende të përparuara të botës, por edhe në vende që kishin provuar të kaluarën komuniste, ka filluar të mendohet për nevojën e mësimi klinik. Në rastin e Kosovës kjo çështje do të duhej që të kombinohet me reformën që do të duhej të bëhet qoftë në Fakultetin Juridik, apo që të gjendet ndonjë mënyrë tjetër e aftësimit praktik, qoftë përmes hapjes të një instituti të specializuar (Magjistraturë), në të cilën kandidatët do të aftësoheshin për të ushtruar funksionin e zbatuesit të ligjit, apo ndonjë formë tjetër të aftësimit praktik.

Nga shumë mendime që janë dhënë për gjyqësorin ka mendime se kadri i gjyqësorit që ishte në kohën nën administrimin e UNMIK-ut ishte tejet i shtyrë në moshë. Kjo vlen jo vetëm për gjyqtarët, por edhe për stafin mbështetës. Gjatë administrimit të Misionit të Kombeve të Bashkuara asnjëherë nuk u mendua në sigurimin e vazhdimësisë të ngritjes profesionale dhe avancimit të gjyqtarëve të rinj dhe përfshirja e tyre brenda kolegjeve të gjyqtarëve me përvojë. Andaj në kuadër të reformës së gjyqësorit duhet domosdo të mendohet për vazhdimësinë. Me kalimin e kohës së nevojshme në detyrat e punës gjyqtarët me eksperiencë duhet të pensionohen, por kjo eksperiencë e tyre njëkohësisht të jetë që më parë e bartur tek një gjyqtar tjetër më i ri i cili do të bënte zëvendësimin e nevojshëm. Mendojmë se ngritja profesionale e një gjyqtari nuk mund të bëhet brenda një afati të shkurtër, por kjo domosdoshmërisht merr shumë kohë. Kur jemi tek angazhimi i kadrove të reja mendojmë se ky proces duhet të jetë shumë rigoroz duke bërë përzgjedhjen më të mirë të mundshme, sepse përfundimi i përgatitjes shkollore edhe në kushtet kur është bërë hapja e shumë institucioneve shkollore të arsimit privat dhe mungesa e kriterëve të nevojshme të vlerësimit, lë shumë për të dëshiruar. Po ashtu është e nevojshme që të shikohet edhe puna e mëparshme e kandidatit përkatës, sjelljet e tij të mëparshme, se a janë ato në kundërshtim me funksionin e gjyqtarit dhe a e bëjnë atë të denjë që të ushtrorë profesionin e gjyqtarit. Të gjitha këto duhet që të merren parasysh në procesin e riemërimit të gjyqtarëve, i cili proces duhet që të ndodhë në sistemin gjyqësor dhe është ndër proceset kyçe që do të ndihmojë reformën në gjyqësor.

E njëjta gjë do të vrente edhe për stafin ndihmës. Edhe për stafin ndihmës duhet të mendohet profesionalizimi i tij dhe procedurat e punësimit duhet që të ndryshojnë rrënjësisht nga e kaluara. Në kohën nën administrimin ndërkombëtar në Kosovë angazhimi i stafit ndihmës në të shumtën e rasteve është bërë dhe kuptuar si zgjidhje e çështjes së punësimit e jo zgjedhja e personit adekuat për kryerjen e detyrave të nevojshme. Kjo kompetencë nuk ka qenë në duart e gjykatave, por, që Departamenti i Administratës Gjyqësore e më vonë Këshilli Gjyqësor kanë vendosur në Prishtinë për personin i cili ka pasur të punojë në gjykatën e cilit do rang dhe cilësdo komunë. Në të ardhmen është e nevojshme që kjo çështje të bartet nëpër gjykata e posaçërisht kur ka të bëjë me stafin i cili drejtpërdrejt ka ta bëjë me gjykatësin të merret mendimi i tij. Kjo për arsye se efikasiteti i punës së gjyqtarit është i lidhur domosdo me punën e sekretarit juridik të tij (daktilografit). Përfshirja sa më e madhe të jetë e mundur e kuadrit të ri në sistemin gjyqësor dhe aftësimi edhe i stafit mbështetës në përputhje me nevojat e reja për punën në administratën gjyqësore, do të jepnin rezultatet e para drejt ndërtimit të një sistemi gjyqësor ashtu siç i duhet në të ardhmen Kosovës.

Përmirësimi i kushteve të punës së punonjësve të gjykatave e posaçërisht gjyqtarëve, është një ndër nevojat e ngutshme të reformës së gjyqësorit. Pajisjet e vjetruara së tepërmi dhe ngadalësia e panevojshme me pajisjen e gjykatave janë çështje që nuk duan justifikim. Gjyqtarët, në mungesë të kompjuterëve portabël, ende i mbajnë me dorë procesverbalet nga shikimet në terren, të cilët do të ishin shumë të përdorshëm për raste të tilla. Po ashtu edhe përmirësimi i ambienteve të punës, i sallave të nevojshme do të shtonin efikasitetin e gjykatave.

Në kushtet e kalimit të Sistemit Gjyqësor nga Administrimi i Misionit të Kombeve të Bashkuara në kushtet e një shteti të pavarur, por me një mbikqyrje tjetër ndërkombëtare, Sistemi Gjyqësor në të ardhmen së pari duhet që të ndërtojë figurën e gjykatësit si personi kyç në këtë sistem, ta çojë në vend dinjitetin e tij duke e veshur atë me atributet e një personi zyrtar të besueshëm për vendosjen e dinjitetshme të çështjeve gjyqësore, t'i respektojë imunitetin, t'i bëjë ngritjen e nevojshme të pozitës materiale, të ashpërsojë kriteret e emërimit për gjyqtarët në drejtim të përzgjedhjes së personave të merituar, të

ashpërsojë masat lidhur me shkeljet disiplinore dhe kur krejt kësaj i shtohet angazhimi i numrit të nevojshëm të gjyqtarëve nëpër gjykata dhe stafit ndihmës, atëherë edhe rezultatet nuk do të mungojnë. Po ashtu, domosdo është e nevojshme që ndarja e buxhetit të rregullohet në atë mënyrë që gjyqësori të mos jetë i ndikuar nga qeveria. Kjo gjë nuk ishte bërë në Kosovë nën administrimin e Kombeve të Bashkuara dhe mendojmë që domosdo duhet që të bëhet në kushtet e misionit tjetër të ardhshëm.

Në kushtet e veprimit të misionit të ardhshëm është e nevojshme krijimi i një strukture të përbashkët dhe Këshilli Gjyqësor të mos jetë përgjegjës vetëm për vendorët, por e njëjta strukturë të vlejë edhe për gjykatësit ndërkombëtarë. Gjykatësit ndërkombëtarë nuk duhet që në të ardhmen të jenë tejet të favorizuar dhe të vishen me attribute më të mëdha imuniteti dhe të kenë pozitë shumë më të favorshme se sa vendorët. Po ashtu edhe ata nuk duhet që të ndikohen nga organet ekzekutive (përfaqësuesi i lartë ndërkombëtar) lidhur me vazhdimin apo mos vazhdimin e kontratave e të cilat gjëra do të kishin ndikimin e tyre në proceset e caktuara gjyqësore dhe ndikim në rrjedhën e tyre. Ata gjithashtu duhet që të jenë përgjegjës edhe në rastet e papërfunduara gjyqësore dhe mos të ndodhë që në të ardhmen për mungesë përgjegjësie të gjykatësve ndërkombëtarë personat e caktuar të mbesin pa marrjen me shkrim të aktgjykimit për muaj të tërë, apo e dhe vjet dhe të mbesin në vuajtje të dënimit për një kohë të gjatë dhe të mos u mundësohet që të ushtrojnë mjetet e ankimit, siç ka ndodhur në kohën e administrimit të Kombeve të Bashkuara.

Vlen të theksohet se krahas kryerjes së reformës në Sistemin Gjyqësor është e nevojshme që të ndërtohen edhe mekanizmat përcjellës më të cilët ka bashkëpunim gjyqësori. Reformë e tillë është e nevojshme që të bëhet edhe në avokati, në prokurori, policinë e Kosovës, në Shërbimin korrektues, në Institucionet e përkujdesjes sociale, shërbimeve postare etj.. Këto institucione janë të lidhura jetësisht ndërmjet veti dhe ndikojnë në reformimin e njëra-tjetrës.

Mendojmë se edhe institucionet e tjera si qeveria, bankat, institucionet e pushtetit lokal etj., duhet që të vetëdijesohen se vendimet e gjykatave janë të përmbarueshme dhe që të

mos shfaqen barriera në ekzekutimin e tyre. Kujtojmë se jo rrallë herë në këto vite këto institucione kanë bërë zvarritje të panevojshme të procedurave të këtilla. Bankat janë munduar që të ruajnë klientët e tyre kurse, sa u përket qeverisë (ministrive përkatëse) dhe organeve vendore të pushtetit lokal ato vonë e kanë kuptuar se pushtetit gjyqësor duhet t'i përgjigjen që të gjithë dhe se vendimet e tilla janë të obligueshme për të gjithë.

Krijimi i praktikave të mira si institucione jashtë gjyqësorit të cilat do të merreshin me vetëdijesimin e publikut për rëndësinë e gjyqësorit si një pushtet i cili mbron dhe shëron shoqërinë nga dukuritë negative. Këto praktika do të ndikojnë edhe në vetëdijesimin e punonjësve të gjyqësorit për rëndësinë që ka puna e tyre për shoqërinë dhe të ardhmen e shtetit të Kosovës.¹⁰

3. Konkluzion

Reforma e gjyqësisë është ndër reformat kryesore në kuadrin e reformave të përgjithshme që po bëhen dhe duhet të bëjë në të ardhmen shoqëria kosovare. Kjo nënkupton rregullimin me ligj të një organizimi të ri të gjyqësisë, duke krijuar në këtë mënyrë kushte për pavarësinë maksimale të pushtetit gjyqësor nga dy shtyllat e tjera të pushtetit shtetëror: Legjislativit dhe Ekzekutivit. Gjyqësia e pavarur është gurthemeli i shtetit ligjor dhe i sundimit të ligjit. Ky koncept në vete nënkupton pavarësinë institucionale dhe personale.

Gjyqësori duhet të ndërmarrë hapa radikal në kryerjen e reformës në këtë segment mjaft të rëndësishëm të shtetit të Kosovës. Kjo reformë mendoj se duhet të bëhet në dy drejtime. E para, duhet që të vazhdohet me përmirësimin e infrastrukturës ligjore e cila do të nënkuptonte zëvendësimin e ligjeve të së kaluarës me ligje të reja, zbatimi i dispozitave të të cilave ligje do t'i përgjigjej realitetit të kohës, si dhe përpjekjeve të vazhdueshme drejt plotësimit të ligjeve të nxjerra dhe evitimit të atyre dispozitave të cilat nuk kanë treguar efektivitetin e nevojshëm në praktikë. E dyta, duhet që të bëhen ndryshime radikale në mënyrën e të punuarit brenda gjykatave, ndërrimit të mentalitetit të

¹⁰ Rafet Haxhaj, *Sistemi Gjyqësor i Kosovës gjatë periudhës së misionit të Kombeve të Bashkuara*, Punim i magjistraturës, Fakulteti Juridik në Prishtinë 2008, fq. 116.

vjetër, evitimit të procedurave burokratike dhe ndërrimit të rrënjësishëm të rregullave të brendshme për punën e gjykatave, pastaj futjes në punë të sistemit elektronik të evidentimit, menaxhimit dhe përpilimit të vendimeve gjyqësore. Këto padyshim do të shtonin efikasitetin e gjykatave.

Gjykatat duhet të shkarkohen nga punët që nuk kanë të bëjnë me vendosjen e lëndëve gjyqësore si dhe thjeshtimin e procedurave ekzistuese.

Pavarësia e gjyqësorit është kushti kryesor për funksionimin e shoqërisë demokratike në Kosovë. Kjo pavarësi do të krijohej duke e ruajtur gjyqësorin nga ndërhyrjet e faktorit ndërkombëtar në punët e tij, pastaj nga ndikimet e faktorit vendor etj.

Ndërhyrjet e faktorit ndërkombëtar, në kushtet e misionit të ri do të manifestoheshin posaçërisht tek gjyqtarët ndërkombëtarë, të cilët do të mund të vareshin nga vazhdimi apo mosvazhdimi i kontratave, nga ana e përfaqësuesit civil ndërkombëtar. Po ashtu është e nevojshme që gjyqësori në të ardhmen të jetë i pavarur edhe nga ndikimi i faktorëve vendor qoftë nga ekzekutivi e posaçërisht duhet që të kihet kujdes tek kompetenca e presidentit, që me rastin e emërimeve për gjyqtarë të mos ketë preferenca politike, në mënyrë që të mos krijohet një praktikë dëgjueshmërie në rastet e vendosjes së çështjeve gjyqësore.

Gjyqësori domosdoshmërisht duhet që të ketë autonominë e tij. Kjo nënkupton pavarësinë e gjyqtarit që të vendosë në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën gjyqësore dhe që të mos e ketë frikën se do të përndiqet për mendimin e dhënë me rastin e vendosjes për çështje të ndryshme. Përveç kësaj, gjyqtari duhet që të jetë i pavarur që të vendosë edhe nga eprorët e tij brenda shkallëve gjyqësore. Gjithashtu në autonominë e gjyqësorit ndikon edhe përmirësimi i pozitës materiale të pjestarëve të gjyqësorit. Kur kjo krahasohet me “krenarinë” dhe “kokëfortësinë” që duhet të ketë gjyqtari që të mos bjerë nën ndikimet e ndryshme, atëherë pozita e tij materiale dukshëm ka ndikimin e saj në autonominë e gjyqtarit.

Që të arrihet pavarësia dhe autonomia e gjyqësorit nuk mjafton që kjo të jetë e sanksionuar me aktet normative dhe që të mbetet si e tillë vetëm e shkruar në letër. Është

shumë me rëndësi që të bëhet ndërmarrja e veprimeve konkrete, në mënyrë që të caktohet një linjë buxhetore e cila do të mbikqyret nga një organ i pavarur, apo vetë presidenti në mënyrë që të shmangen “dëshirat” e qeverisë në caktimin e limiteve buxhetore. Gjyqtarët, duke u munduar që të mbesin të paanshëm gjatë administrimit të Misionit të Kombeve të Bashkuara, mbetën edhe jashtë përkujdesit të institucioneve vendore. Ata në kohë të fushatave zgjedhore nuk paraqisnin trup elektoral me rëndësi, kështu që nuk ishin në fokusin e synimeve programore të subjekteve politike dhe në këtë mënyrë lëre që nuk pat përmirësim të pozitës së tyre, por të paktën as edhe premtime se kjo pozitë të përmirësohej. Gjyqësori u shfrytëzua vetëm për retorikë “se do të ketë përmirësim në sundimin e ligjit”.

Në trendet që po kalon Kosova dhe synimet që ka ajo, duhet që të ndërtojë figurën e gjyqtarit duke e veshur atë me imunitetin e nevojshëm, atributet që gjyqtari i ka në shtetet e përparuara demokratike. Gjyqtari të ketë garancitë e duhura se do të jetë me mandat të përhershëm, pas pensionimit të mos bjerë autoriteti i tij siç edhe ka ngjarë me shumë figura të respektuara të gjyqësisë kosovare, kur çastet e fundit të jetës së tyre i kalojnë me një pension i cili nuk u mjafton as për plotësimin e kushteve minimale për jetesë brenda një muaji. Paralel me këtë duhet që të ashpërsohen kriteret për emërimin gjyqtarëve dhe ato për shkelësit e disiplinës dhe etikës së gjyqtarit.

Që të gjitha këto do të ndikonin që të ndërtohet një Sistem Gjyqësor i pavarur dhe i paanshëm që do të ishte baza e një shoqërie demokratike dhe me këtë edhe do të hapej rrugëtimi i sigurtë i Kosovës drejt përshpejtimit të integriteteve aq të pritura në trendet gjithë evropiane.

BIBLIOGRAFI

Literatura shkencore

Abdyli Dr.sc. Ramiz, Bakalli, Dr.sc. Emine : *Historia - II*, Gjinnazi i shkencave shoqërore, botoi Libri Shkollor, Prishtinë, 2004.

Bajrami, Dr.sc.Arsim : *E Drejta Kushtetuese II*, Prishtinë, 1998;

Ismaili, Dr.sc. Osman: *Fillet e së drejtës*, Prishtinë, 2007;

Jashari, Jetish, UN. FIELD MISSIONS IN THE CONTEXT OF LEGAL AND JUDICIAL REFORM: THE KOSOVO CASE, Columbia University School of Law, Volum 1, Nr. 1. 2007;

Rahimi, Shukri : *Vilajeti i Kosovës*, Prishtinë 1969;

Rafet Haxhaj, *Sistemi Gjyqësor i Kosovës gjatë periudhës së misionit të Kombeve të Bashkuara*, Punim i magistraturës, Fakulteti Juridik në Prishtinë 2008.

Publikime të tjera

Indeksi mbi Reformën e profesionit ligjor për Kosovë ABA/CEELI (ABA/Rule of Laë), korrik 2004, tetor 2004 dhe prill 2007;

Kodi i Etikës dhe i sjelljes profesionale për gjyqtarë;

Katalog i Mjeteve Juridike - Misioni i OSBE në Kosovë;

Buletini i Shoqatës së Gjykatësve të Kosovës nr. 1-18.

Ejup Sahiti, *Sistemi Gjyqësor në Kosovë*, kumtesë e mbajtur në Konferencën Rajonale për Punën e Sistemit Gjyqësor, Prishtinë 25-27 prill 2003, botoi KLMDNJ, Prishtinë, 2004;

Akte juridike

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB 1244;

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;

Propozimi Gjithpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës;

Kushtetuta e Republikës së Kosovës 15.06.2008;

Ligji mbi Gjykatat e Rregullta – Gaz. Zyrt. e RSFJ nr.21/78;

Ligji mbi Procedurën Kontestimore – Gaz. Zyrt. e RSFJ nr. 4/77;

Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve – Gaz. Zyrt. e RSFJ nr. 29/78;

Ligji mbi Procedurën Jashtëkontestimore – Gaz. Zyrt. e RSFJ nr. 42/86;

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/25 Për Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës;

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/26 Për Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës;

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/1, 1999/25, 2000/54, Mbi Ligjin në fuqi në Kosovë;

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/52 Mbi Themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.